



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 113 / 17

Nr. i fq. / Br. sh. - 5 -

Data: / Datum 27. 4. 2017

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -II-TË E JASHTËZAKONSHME E -IV-TË ME RADHË E
KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 10 MARS 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Habib Mustafa, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Finesë Hajrizi-Cakoli, Adnan Klinaku, Xhevahire Selmani dhe Melihate Basholli.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së përfaqësuesit e mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – në fillim të takimit njoftoi anëtarët e kuvendit se gjatë muajit mars duhet të bëhet deklarimi i pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Tutje shtoi se sot, kur po bëhen afër tri vite që nga marrja e vendimit të kuvendit komunal për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, pothuajse jemi në ditën finale të saj dhe pranë miratimit. Duke pasur parasysh që është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që merr asambleja komunale, besoj që të gjithë kemi pritur që si të tillë ta votojmë të gjithë me një konsensus të plotë nga të gjithë anëtarët e kuvendit, mirëpo siç edhe po shihet kjo nuk u arrit për disa arsye. Kjo nuk po arrihet sepse tek një pjesë e anëtarëve të kuvendit po mbizotëron arsyeja e shëndoshë dhe po kërkohet që të mbrohet interesi i përgjithshëm, në këtë rast interesi i Komunës së Vushtrrisë. Të gjithë e dimë, por nuk po duam ta themi, as kryetari i komunës nuk po dëshiron ta qartësojë se gjykata e ka marrë një vendim të formës së prerë sa i përket stacionit të autobusëve dhe se komuna është dënuar me mbi 4 milionë euro, dhe mbi dikë duhet të bie përgjegjësia. Megjithatë, sa i përket kësaj seance, me gjithë respektin për anëtarët e kuvendit, unë mendoj që prapë nuk është e thirrur në mënyrë ligjore, sepse ka qenë e pamundur, për arsye se Ligji për Vetëqeverisje Lokale neni 44.4 takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit, po themi nuk është në rregull sepse, kuvendi i komunës i ka 35 anëtarë dhe për këtë

propozimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa bie ndesh me pëlqimin e dhënë nga Ministria përkatëse për këtë plan, dhe unë në fakt isha kundër këtij plani sepse në njëfarë forme imponoheshin këto rekomandime. Edhe njëherë për hir të interesit të përgjithshëm dhe për shkak të humbjes së kohës unë shpreh qëndrimin tim se e mbështes këtë plan zhvillimor me vërejtjet përmbajtjesore, të cilat janë dhënë nga kolegët, plan ky i cili ka marrë pëlqimin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ju bëjë thirrje të gjithë kolegëve të mi të mos humbim më kohë sepse humbja e kohës po e shndërron këtë plan një lloj pazarllëku të dikujt dhe pretendimin e dikujt të marrë primatin se po mbron këtë apo atë interes, por të bëhemi të gjithë së bashku me një lloj konsensusi dhe të kalojmë ky plan gjithmonë për të mirën dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve tanë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se e përkrah propozim-dokumentin e hartuar nga qeveria komunale të cilën e udhëheq Kryetari i komunës z. Bajram Mulaku. Tutje shtoi se i vjen keq për "shokët e tij" dhe shtoi se ata prapë i konsideron shokë edhe përkundër dallimeve që e kanë lidhur me këtë propozim-plan. Në fund theksoi që ai është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës Dega në Vushtrri dhe për këtë ndihet mirë dhe i nderuar.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – tha se është bërë mjaftueshëm sa i përket Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024 dhe për këtë çështje kanë pritur mjaft edhe qytetarët e edhe bizneset dhe kjo është në interesin e tyre që sot të aprovohet ky dokument. Në vazhdim ceku se i vjen keq për koleget e saj që e lëshuan takimin dhe ritheksoi se kisha dashur që ky plan të aprovohet me konsensus të plotë politik. Në fund tha se e përkrah në përgjithësi këtë plan e veçanërisht që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore, kurse njoftoi se vota e saj do të jetë "për" sa i përket këtij plani.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për PZHK-në, duhet të japin përgjegjësi ata që mbledhjen e kaluar të kuvendit, tentuan që me çdo kusht të aprovojnë këtë dokument pa e pasur kuorumin. Pastaj ritheksoi që e përkrah propozimin që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore. Në fund tha se ky dokument duhet të përmirësohet edhe në shumë pika tjera, dhe njoftoi se grupi kuvendar i LVV-së do të abstenojë sa i përket votimit të këtij plani.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit – tha se lidhur me PZHK-në janë zhvilluar shumë debate dhe diskutime dhe tani ka ardhur koha që ky dokument të aprovohet me qëllim që t'i hapim rrugë zhvillimit të bizneseve. Pastaj ceku se nuk kemi dëshirë askush që kolegët tanë ta lëshojnë sallën dhe apeloj se mendimet e shprehura në kuvend nuk duhet marrë në baza personale. Në kuptim të kësaj vlerësoi se duhet që ky plan të aprovohet pasi kemi obligim ndaj qytetarëve tanë, të cilët na kanë votuar. Pastaj shtoi se ky plan ka gabime teknike, por në përgjithësi është një dokument i mirë dhe ceku se është i pajtimit që zona e tetë të jetë zonë e ndërtimit. Në fund tha se duhet të hiqet fjalia ku thuhet se më herët hamami i qytetit ka qenë kishë katolike.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – në rekapitullimin e debatit lidhur me Planin Zhvillimor Komunal tha se për aprovimin e këtij dokumenti janë plotësuar kushtet ligjore, sepse janë mbajtur debatet me qytetarë, si dhe është marrë edhe pëlqimi nga ministria gjegjëse. Pastaj njoftoi se bazuar në dispozita ligjore në fuqi kuvendi i komunës nuk mund të marrë vendime kapitale në afat prej gjashtë muajve para mbajtjes së zgjedhjeve, andaj në këtë kontekst vlerësoi se tani është koha që ky dokument të aprovohet nga ana e kuvendit, në afat ligjor dhe kështu t'i jepet mundësi e zhvillimit qytetit përmes ndërtimeve dhe zhvillimit të biznesit dhe hapjeve të vendeve të reja të punëve. Mandej përsëriti se tani kemi një propozim për këtë plan të ofruar nga ana e qeverisë komunale dhe i cili është aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sipas vlerësimit të saj strategjik në kuptimin e mjedisit ka dhënë pëlqimin dhe e ka aprovuar këtë dokument. Pastaj sqaroi se në arsyetimin e Ministrisë së Mjedisit janë përcaktuar edhe kriteret që duhet t'i zbatohet komuna dhe këto janë obligim që të respektohen nga ana e komunës. Në fund duke u bazuar në diskutimet e anëtarëve të kuvendit, si dhe në pëlqimin e dhënë nga Ministria e Mjedisit e hodhi në votim Draft-Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas deklarimit me 16 vota "për" (Shkelzen Feka, Agim Bregaj, Hysni Gërguri, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Agron Përçuku, Muharrem Shabani, Bahrije Pllana, Sabri Ferati, Mentor Ferizi, Qerim Selimi, Fakete Dushi, Ergin Sunguri, Arta Ismajli, Rrahim Ajeti, Shaban Beka) dhe 4 vota "abstenim" (Ali Januzi, Mehmet Selaci, Myrvete Hetemi, Mirjeta Salihu), vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2024.
2. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmerë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë këtë çështje.
3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ta zbatojë dhe që të regjistrojë në RDPP të dhënat e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Plani Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, shfuqizohen: Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Vushtrrisë 2009-2014, Plani Rregullues Urban - zona 1-"QENDRA", Plani Rregullues Urban - zona 2-"URA E GURIT", Plani Rregullues Urban 3 -"LUMI TËRSTENA".
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:39.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Muharrem Shabani



Anëtar i Kuvendit

